

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Banorët e Prrenjasit kundërshtojnë bashkimin me Librazhdin: Vullneti i qytetarëve duhet të respektohet
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/banoret-e-prrenjasit-kundershtojne-bashkimin-me-librazhdi-n-vullneti-i-i103177
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 08:24:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 08:19:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4190afd04761db7346aaf81d037778f86df6e1e1567870133f082870d8e816f5
TEKSTI	4beb5ead7bfe98647f4e74f5f082d3497a5978e6b62f270ded08368546466203
PAMJA	0dba4bb555a1d18bc417d72e858059f15d3b008562ef686e6233ca7a6fea2b6d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	364cb562da4bebd84f2b3671bf31e6a4491eeb4c53f6c0e6970c1baa03878213
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/364cb562da4bebd84f2b3671bf31e6a4491eeb4c53f6c0e6970c1baa03878213>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

 SYRI LIVE



Flash: [qytetarëve duhet të respektohet](#) [Dyshohet se ka ndodhur në](#) [Biseda ishte konstruktive](#) [Dojkoton seancën](#) [tre punonjësve](#)

 AKTUALITET

Banorët e Prrrenjasit kundërshtojnë bashkimin me Librazhdin: Vullneti i qytetarëve duhet të respektohet

Piranjat Përditësimi i fundit 9 Shtator 2026, 10:19



 Banorët e Prrrenjasit kundërshtojnë bashkimin me Librazhdin:

Këshilli Bashkiak i Prrrenjasit ka nisur zyrtarisht turin e konsultimeve publike me qytetarët në kuadër të Reformës së Administrative Territoriale, proces që parashikon zhvillimin e gjashtë dëgjësave publike në të gjithë territorin e bashkisë.

Dëgjesa e parë u zhvillua në Njësinë Administrative Qukës, ku banorët shprehën një qëndrim të unifikuar kundër propozimit për bashkimin e mundshëm të Bashkisë Prrrenjas me Bashkinë Librazhd.

Gjatë diskutimeve, qytetarët paraqitën argumente të natyrës ekonomike, gjeografike dhe administrative, duke kundërshtuar një zgjerim të mëtejshëm territorial të njësisë së tyre vendore.

Sipas banorëve, një bashkim i tillë do të sillte pasoja në ofrimin e shërbimeve publike, pasi distancat më të mëdha nga qendra administrative do ta vështirësonin aksesin e qytetarëve në institucionet vendore. Ata ngritën gjithashtu shqetësimin për rritjen e kostove dhe vështirësive logjistike për marrjen e dokumenteve dhe shërbimeve bazë.

Një tjetër argument i përsëritur gjatë dëgjësës ishte ruajtja e identitetit dhe përfaqësimit lokal. Banorët theksuan se një riorganizim territorial duhet të marrë në konsideratë specifikat e komuniteteve dhe nevojën për një administratë sa më pranë qytetarëve.

Përveç kundërshtimit ndaj bashkimit të mundshëm me Librazhdin, gjatë takimit u shfaqën edhe kritika të forta për mënyrën se si po zhvillohet procesi i konsultimit.

Disa prej banorëve e cilësuan dëgjësën si një “fasadë” dhe “farsë të radhës”, duke argumentuar se Komisioni i Posaçëm Parlamentar duhet të kishte zhvilluar konsultime me komunitetet në terren përpara hartimit të drafteve apo propozimeve për ndryshimin e hartës administrative.

Në qendër të diskutimeve ishte edhe roli i deputetëve që përfaqësojnë zonën në Kuvendin e Shqipërisë. Banorët kërkuar prej tyre një qëndrim të qartë mbi këtë çështje dhe që vullneti i shprehur nga komuniteti të përfaqësohet edhe në procesin parlamentar.

Sipas tyre, deputetët e zonës duhet të marrin në konsideratë kundërshtimin e qytetarëve dhe, në rast se propozimi për bashkimin e bashkive shkon për votim në Kuvend, të votojnë kundër tij.

Në mbyllje të dëgjësës, banorët e Qukës kërkuar që të gjitha argumentet dhe qëndrimet e shprehura gjatë takimit të pasqyrohen në mënyrë të plotë në procesverbalin zyrtar dhe t’u përcillen institucioneve përgjegjëse.

Ata insistuan që konsultimi publik të mos mbetet thjesht një procedurë formale, por që zëri i komunitetit të merret realisht në konsideratë gjatë vendimmarrjes përfundimtare mbi Reformën Administrative Territoriale.

Procesi i konsultimeve do të vijojë edhe në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Prrrenjas, ndërsa qëndrimi i banorëve të Qukës shënon reagimin e parë publik në këtë seri dëgjësash ndaj propozimit për një riorganizim të mundshëm territorial.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 9 Shtator10:11

[Kreu i Shërbimit Zjarrfikës reagon për shpërthimin tek “Eida”: Dyshohet se ka ndodhur në zyrat e pikës së karburantit! Pati edhe rrjedhje gazi](#)

Shkëlqim Goxhaj, Drejtori i Shërbimit Zjarrfikës të Tiranës dha detaje në lidhje me shpërthimin e ndodhur mëngjesin e ...

AKTUALITET 9 Shtator09:58

[Prrrenjasi kundër bashkimit me Librazhdin, banorët kundërshtojnë reformën territoriale: Vullneti i qytetarëve duhet të respektohet](#)

Këshilli Bashkiak i Prrrenjasit ka nisur zyrtarisht turin e konsultimeve publike me qytetarët në kuadër të Reformës së Ad...

AKTUALITET 9 Shtator09:52

[Zbardhen dy vjedhje në Korçë, arrestohet 18-vjeçari dhe shpallet në kërkim bashkëpunëtori](#)

Policia e Korçës ka zbardhur dy raste vjedhjeje të ndodhura në qytet dhe ka arrestuar një prej autorëve të dyshuar, nd&eu...

AKTUALITET 9 Shtator09:37

[Shpërrimimi tek karburanti “Eida”, ja si eshte gjenja e tre punonjesve](#)

Ministria e Shëndetësisë ka dhënë informacion të ri për gjendjen shëndetësore të tre personave të dëmtuar...

AKTUALITET 9 Shtator08:50

[Para nisjes së shkollave, Hita zbret në Korçë/ Ja porosinë për policinë vendore](#)

Pak ditë para nisjes së vitit të ri shkollor, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita, zhvilloi nj...

AKTUALITET 9 Shtator08:26

[KPP i hap rrugë tenderit 7.8 milionë euro për mirëmbajtjen e fiskalizimit](#)

Komisioni i Prokurimit Publik i ka hapur rrugë vijimit të tenderit me fond limit 7.8 milionë euro për mirëmbajtjen e sistemit të...

Piranjat News AKTUALITET 9 Shtator08:18

[Policia reagon për shpërthimin te “Brryli”: Tre të dëmtuar, hetimi në vazhdim](#)

Një bombul gazi dyshohet se ka shpërthyer sot në një stacion karburanti në zonën e “Brrylit”, në Tiranë, n...

AKTUALITET 9 Shtator08:01

[Tre punonjës të plagosur dhe një godinë e shembur, çfarë la pas shpërthimi te karburanti në Brryl](#)

Një shpërthim i fuqishëm ka ndodhur mëngjesin e sotëm në karburantin “EiDA”, në zonën e Bërrylit n&eu...

AKTUALITET 9 Shtator07:51

[Flamuri zviceran mbi Legatën amerikane: Letra e fundit zyrtare e SHBA para se Shqipëria të hynte në errësirë](#)

Më 14 shtator 1944, ndërsa fundi i Luftës së Dytë Botërore po afrohej dhe Shqipëria po hynte në një nga periudhat...

AKTUALITET 9 Shtator07:36

[Shpërthim në një pikë karburanti, shembet një godinë një katëshe! Shikoni pamjet](#)

Një shpërthim ka ndodhur në zonën e Brrylit te një pikë karburanti Eida. Burime bëjnë me dije se ka shpërthyer n...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 8 Shtator

[Bosi i drogës në kërkim nga SPAK filmoi në hote...](#)

Një figurë e krimit të organizuar, në kërkim nga SPAK për trafik droge, pastrim parash dhe organizatë kriminale, i niohur p&e...

AKTUALITET 8 Shtator

[EMRAT/ U qëlluan me armë zjarri, kush janë dy t...](#)

Dy persona janë plagosur me armë zjarri mbrëmjen e sotme në zonën e Laprakës në Tiranë. Ngjarja dyshohet se ka ndodhur ...

Piranjat News AKTUALITET 8 Shtator

[Iu përmend emri në audiopërgjim, rrezikohet jet...](#)

Gazetari Julian Hoxhaj ka reaguar pasi emri i tij dhe emisioni “Plug”, pjesë e Syri TV, janë përmendur në një audiopë...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafigas, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!



Reagon Cllevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur



Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.



Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme



Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.



Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Gruaja me dy identitete që premtun “shërim” me ujin e kufomave në Pejë



A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?



Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët



Flamur Gjuzi, i dënua për “shpërdorim detyre” sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?



Pallatet u zhytën “Durrës Marina” dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit



Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15



Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)



Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës



Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.



Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje



Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.



Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.



“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet



Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14



Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas



Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi



Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime



Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote



Artisti dhe Frika



Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe ‘lufta’ për 200 mijë euro!



14-vjeçare me dr*gë dhepro*titucion, rrjeti i errët i minoreneve të zhdukura



Zhytja e pallateve te Alabarit/ IKMT pranon anomalitë në “Durrës Marina”: Janë zhytur 28 cm



"Ederlezi", festa e veçantë e komunitetit rom.



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 13



Do t'i fus duart edhe nëse bërtet, motra e 13 vjeçares rrëfen tmerrin e mesazheve që mësuesi ia çon



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.